

ALBERTO MANCO*

**TEKSTET E NDËRMJETËSUARA NGA TEKSTE
PËRKOHSHMËRIA DHE NDËRSHTËNIA
TEKSTORE/PERTEKSTUALITETI**

Fusha e tekstorësisë, e përcjellë përmes vetë tekstorësisë, nuk i ka përvijuar ende mirë kufijtë dhe kjo ka kushtëzuar edhe mungesën e emërtimeve për të shënuar me saktësi dukuritë përkatëse. Me synimin e një sprove për nxjerrjen në pah dhe klasifikimin fillestar të shfaqjeve të tilla tekstore, në pjesën e parë të këtij punimi do të përpiqemi t'i emërtojmë si të "të përkohshme" këto tekste të shkruara në vende a sipërfaqe që nuk janë plotësisht të qëndrueshme, si pjesët e trupit (p.sh., lëkura, thonjtë, etj.), veshjet, muret dhe sipërfaqe të tjera (porta, pajisje etj.) të banjave publike, të bankave të shkollave, të mureve të jashtme, të stolave, të pemëve, e të tjera. Objektivi është të përpiqemi të sugjerojmë nevojën e zhvendosjes së opinionit për tekste të tilla nga një konsideratë përgjithësisht e rrenjosur, që i sheh si të përkohshme, të paqëndrueshme, në një arsyetim metagjuhësor të formuluar mirë; dhe t'i çmojmë ato si të vlefshme, kur zakonisht janë konsideruar pa ndonjë vlerë tekstore. Ndërsa në pjesën e dytë të punimit do të mundohemi të izolojmë tri tipe dukurish për të cilat propozojmë termat "kryqëzim tekstor"/ "crosstekstualitet", "ndërshtënie tekstore"/"pertekstualitet" dhe "mbivënie tekstore"/"surtekstualitet".

Do të ndalemi në veçanti në tipin e dytë tekstor dhe do të synojmë të gjejmë te "rrëfimi i animuar"/ "fumetto"¹ një nga hapësirat e privilegjuara të shfaqjes së tij, si dhe do të përpiqemi ta përshkruajmë atë.

Fjalët çelës: gjuhësi, tekstorësi e përcjellë përmes vetë tekstorësisë, tekst i ndërshtënë/ pertekst, tekst i përkohshëm.

* Profesor i lëndëve *Linguistica generale* e *Linguistica testuale* në Universitetin e Napolit "L'Orientale". Teksti në vazhdim është përpunim i një konference të mbajtur pranë ASA në muajin shtator 2017.

¹ Kemi zgjedhur termin "rrëfim i animuar" si gjegjëse të fjalës "fumetto" (italisht), përkundrejt varianteve të tjera që kanë qarkulluar në trojet shqipfolëse, si "strip", në Kosovë (nga serbishtja); "novelë grafike" në Tiranë. (shënim i përkthyeses)

1. Tekstorësia dhe tekstet e përkohshme. Shtrimi i çështjes.

1.1. Teksti i përkohshëm

Disa tekste, për shkak të bazamentit a vendit ku janë shkruar, karakterizohen nga një qëndrueshmëri dhe kohëzgjatje mjaft e kufizuar. Për këtë motiv, tekste të tilla mund të quhen “të përkohshme”. Ato mund të kenë, gjithsesi, një forcë pragmatike më të madhe se të tjera, që zakonisht nuk konsiderohen si të përkohshme. Por njëkohësisht, “tekstet e përkohshme” vështirë se trajtohen në kategorinë e teksteve me autoritet, siç janë për shembull mbishkrimet popullore të periudhës mesjetare, ndonëse këto mund të përfshihen gjithsesi në tipologjinë e teksteve të përkohshme.

Gjithashtu, teksti i përkohshëm mund të karakterizohet nga karakteri ilokutiv, meqë shpesh konsiston në një pyetje, një lutje, një urdhër, një kërkesë, etj. Pra, qëndrueshmëria e teksteve të përkohshme mund të luhet nga pak çaste (siç është një shkrim në rërë) deri në kohëzgjatjen e një jete njerëzore (siç është tatuazhi, tekst i karakterizuar nga një vlerë pragmatike e fortë sipas funksionit që është thirrur të kryejë, terapeutik, ritual ose zbukurues). Ndonëse në formë kampionesh, është i nevojshëm klasifikimi sistematik dhe tipologjik i teksteve të përkohshme në bazë të karakteristikave të tyre tekstore që i bashkohen; njëkohësisht, gjerësia e përdorimit të konceptit të “përkohshmërisë” na fton të kryejmë dhe një arsyetim teorik të posaçëm. Prandaj dhe, duke parafrazuar Cacchioli-n dhe Tiburzi-n (2014), në lidhje me analizimin e të dhënave mbi disa “shkrime të ekspozuara”, mund të thuhet se edhe për tekstet e “përkohshme” bëhet i nevojshëm përdorimi i “një metode hetimi dhe analize ende për t’u përpunuar”. (Cacchioli e Tiburzi 2014, 312).

1.2. Bazamenti, procedura, vonesa

Shumë fusha të ndryshme të studimit të shkrimit dhe historisë së gjuhëve shfaqin interes për tekstet pa peshë “zyrtare” apo “autoritet”.

Paolo D’Achille (2010, 236), për shembull, trajton “karakterin shumë të ndryshëm [që] kanë shkrimet murale spontane, vepër për më tepër e të rinjve, ndonjëherë gjysmë të arsimuar”; ai kujton gjithashtu një kategori tjetër, atë të “grafiteve”, për të cilat ndonjë studim (Guerra 2012, 4) thekson rëndësinë e hetimit statistikor në areale të ndryshme. Mund të vazhdohet me shembuj të këtij lloji dhe ajo që bie në sy është mungesa e terminologjisë për të shënuar tipet e ndryshme të shkrimeve të cilave u referohet. Në fakt, për të shënuar shkrimet në lëkurë, në banderolat sportive, në logot komerciale, tekstet e stampuara në veshje, veprat e *writers*, shkrimet në kontekste burgjesh dhe të gjitha tekstorësitë e tjera të mundshme që klasifikohen në një farë mënyre si “të përkohshme”, ripërdoret gjithmonë terminologjia ekzistuese e cila nuk mjafton duke i identifikuar në mënyrë të paplotë si “mbishkrime”, “shkrime murale spontane”, “grafite” etj. Përcaktime të tilla janë të qarta për disa qëllime, por nuk

plotësojne nevojën gjuhësore për të pasur të dhëna paraprake mbi tiparet e tyre tekstore të ndryshme. Gjithashtu, në literaturën për analizën e tekstit mungon thuajse krejtësisht referimi për bazën mbështetëse (bazamentin), për procedurën dhe transferimin e tekstit të përkohshëm në kontekste të tjera tekstore, ose të elementeve që duhen pasur parasysh kur analizohet teksti.

Pikërisht për këto motive që sapo u përmendën nuk duhet gjykuar teksti i përkohshëm në bazë të kohëzgjatjes së bazamentit, që herë-herë tejkalon çdo parashikim kohëzgjatjeje, por për intensitetin e tij informues që mund të jetë shumë i rëndësishëm për atë që e ka prodhuar dhe që mund ta marrë papritur për ndonjë marrës tjetër. Prandaj dhe përkohshmëria nuk paragjykon tekstorësinë si e tillë, as nuk i pengon tekstet e përkohshme të hetohen dhe klasifikohen, arkivohen dhe analizohen.

Ky parashtrim i shkurtër ishte i nevojshëm për të kaluar në një rrafsh tjetër reflektimi në lidhje me rastin kur një tekst - i përkohshëm ose jo - riprodhohet në një tekst tjetër (për shembull në një “rrëfim të animuar”, një publicitet, një film, një *videogame* etj.).

2. “Ndërshtënia tekstore”/“pertekstualiteti”. Përcaktimi dhe statusi

Përcaktimet e “tekstit të mbivënë”/ “surtekstit”, “tekstit të ndërshtënë”/ “pertekstit” dhe “tekstit të kryqëzuar”/“crosstekstit” lindin nga nevoja për të shpjeguar dukuri të veçanta, të cilat mund të veçojnë nga ana e tyre disa nënklasifikime. Ato u referohen në veçanti situatave ku një tekst i përkohshëm ndërmjetësohet prej një teksti më të ndërlikuar. Pra, propozohet të quhet “tekst i mbivënë” një tekst i përkohshëm, që prodhohet mbi një bazament/vendshkrim të caktuar, p.sh., një kartëvizitë, apo një targë, që vendoset në mënyrë të dukshme mbi një vendshkrim tjetër që nuk është tekst me figura apo tekst letrar (p.sh., mbi një skulpturë apo mbi një veshje); emërtimi “mbivënie tekstore” kryehet, pra, në përputhje me paraqitjen e vendshkrimit. Nga ana tjetër, një tekst i përkohshëm që paraqitet në mënyrë të dukshme në një tekst me figura, p.sh., në një “rrëfim të animuar” apo në një publicitet, mund të quhet “tekst i ndërshtënë”; dhe emërtimi i “ndërshtënies tekstore” bëhet, pra, në përputhje me paraqitjen e vendshkrimit. Së fundi, kur në një tekst letrar evokohet një tekst i përkohshëm, verifikohet një rast i “kryqëzimit tekstor”.

Në listën që sapo cituam, duhet theksuar se raporti i ndërmjetësisë mes tekstit të shkruar dhe kontekstit ku ai shfaqet, rregullohet në bazë të një tendence në zbritje të “materialitetit/natyrës lëndore” dhe tendence në rritje të “metatekstorësisë”, gjë që na detyron t’i analizojmë fillimisht ndarazi fenomenet që më vonë do të analizohen në një rrafsh të përbashkët.

Tekstet e “mbivëna” dhe ato të “kryqëzuara” kërkojnë secila një studim të kujdesshëm, që nuk mund të kryhet në mënyrë të pasaktë në hapësirën e

citimeve, por duhet të gjejë vend në hapësirën “tekstore”. Përmendim këtu një shfaqje të “mbivënies tekstore” kur, *t-shirts*-et bëhen – në mënyrë emblematike – bartëse të shkrimeve që karakterizohen nga një autonomi e fuqishme tekstore; ndërsa një rast i “kryqëzimit tekstor” mund të motivohet mjaftueshëm në vargjet e Toti Scialoja-s, ku: “...lo striscione TRAGUARDO// copre metà tramonto “[...] shiriti që shënon MBËRRITJE// mbulon gjysmën e perëndimit të diellit [...]” (Scialoja 2009, p. 25). Siç nënkuptohet, çështja nuk mund të zgjidhet menjëherë në mënyrë të thjeshtë dhe të mund të jetë e dobishme që ajo të vihet përballë çështjeve të tjera të lidhura me “ndërtëstorësinë”/ “intertekstualitetin (p.sh., Bazzanella 2004), ndonëse nuk kanë të bëjnë me tekstorësinë/ “tekstualitetin” e ndërmjetësuar nga vetë “tekstorësia”/ “tekstualiteti”. Duke e lënë për një tjetër rast çështjen e “mbivënies tekstore” dhe “kryqëzimit tekstor”, dhe duke u kufizuar në këtë punim vetëm te “ndërshtënia tekstore”, mund të themi se, nëse paraqitja te një tekst me figura, i një teksti të shkruar mbi një bazë/vendshkrim të caktuar, mund të quhet “ndërshtënie tekstore”, atëhere teksti i paraqitur mund të përcaktohet si tekst “i ndërshtënë”, “objekti i ndërshtënies”/ “konfigurimi”/ “kornizimi” në të cilin ai bartet; p.sh., një fletore quhet “objekt i tekstit të ndërshtënë”, ndërsa objekti në të cilin paraqitet, p.sh., një “rrefim i animuar” mund të quhet “kontekst i ndërshtënies tekstore”. Do të ishte interesante të shënohej se një analizë statistikore, megjithëse paraprake e “teksteve të ndërshtëna”, tregon se paraqitja e tyre parapëlqen disa tipe, p.sh., titujt e gazetave apo kartëvizitat, por jo të tjera. Këto objekte të ndërshtënies tekstore mund të gjenden, në fakt, te fragmentet e mëposhtme të novelës grafike, siç tregohet në figurat 1 e 2, që mundësohen nga gazeta në rastin e parë, dhe nga shamia në të dytin.



Fig. 1. “BlueBeetle”, vol. 19, 1995 (e përditshme).



Fig. 2. Topolino dhe sekreti i dyfishtë i Njollës së zezë, f. 24.

Mangësia në përcaktimin e natyrës specifike të “teksteve të ndërshtëna” ka bërë që ato të mos merren në konsideratë as në klasifikimin e tipologjive të teksteve që formojnë “rrefimin e animuar”, “kornizën tekstore në formë reje,

balonin a tymin”, siç e shohim në paraqitjen e ngjeshur të listës së ndërtuar nga *Encyclopedia of Language and Linguistics*.²

Është simptomatike, në fakt, mungesa e përmendjes në mënyrë të qartë të “tekstit të ndërshtënë” në kuadër të “leksikut” të “rrëfimit të animuar”, siç është rasti i Walker-it 1980, apo shembujt nga veprat e shumta kushtuar rrëfimit të animuar; u fillua gjithsesi regjistrimi i tyre në arkivin e transkriptimit të teksteve të “rrëfimit të animuar” që nisëm të kryejmë në Napoli, sipas “modelit standard të futjes së të dhënave TEI, i cili bazohet në metagjuhën e tipit XML” (Mancini, në shtyp); regjistrim të cilit i mungonte pikërisht objekti i ndërshtënë, siç e përmendëm.

Nuk duhet të çuditemi, pra, nga fakti se në një përshkrim si ai i Brown-it e të tjerë (2005) mungojnë të dhëna për paraqitjen e tekstit në tekst: tekst i ndërshtënë në një libër, tekst i ndërshtënë në një gazetë, tekst i ndërshtënë në një tabelë, etj.

As në veprën e konsideruar si analiza më e rëndësishme semiotike mbi rrëfimet e animuara³, kur komentohet një fragment i Aleix Barba-s, mjaft i pasur me ndërshtënie tekstore (fig. 3), nuk vihet në pah dhe nuk flitet për numrin e thënieve gjuhësore (“a number of linguistics enunciations”), duke i përzier ato në të njëjtin klasifikim (“the lyrics of the songs, the titles of books and records, the text of the newspaper” (Groensteen 2007, p. 54), pa harruar dallimin mes tipave tekstorë dhe, për këtë, pa e parë të nevojshëm kërkimin e një emërtimi të veçantë për dukuritë e veçanta.

² Brown et al. 2005, s.v. “Comics: Pragmatics”: “There are three main groups of written text in comics: a. text within a balloon; b. text within the panel; c. text at the edge of, or between panels, so-called caption texts”.

³ Groensteen 2007, p. VII: “the most important semiotic analysis of the [comics] published to date”.



Fig.3. Barba Aleix: a winter story, 1985, "Madriz" n. 29, korrik-gusht 1986.

Pas përcaktimeve më lart, mund të thuhet se dallimi mes paraqitjes së shkruar të një rrëfimi të kryer "jo gojarisht", me atë të kryer "gojarisht" mund të përmblihet si në skemën më poshtë, ku vërehet një prirje e fortë

“shkrimore”/”scrittiva”⁴ e tekstit të ndërshtënë, i vetmi që nuk mund të përfshihet edhe në kolonën e teksteve që imitojnë rrafshin tingëllor/ “të zërit” me pretendimin pak a a shumë të theksuar që t’i gjasin atij.

+ SHKRIMOR- SHKRIMOR

ideoshenjafonoshenja
 tekst në didaskalitekst brenda tymit
 pertekst---

Një dallim i tillë përputhet me parakushtet programatike të vetë “rrëfimit të animuar”, teksteve brenda kornizës në formë reje a baloni: të përshkruajë atë që ndodh, të nënkuptuar si vazhdimësi ngjarjesh vizive (d.m.th. të destinuara të shfrytëzohen nëpërmjet shikimit) dhe të zëshme/ “sonici” (që i referohen, pra, përmasës së zëshmërisë)⁵. Paraqitja e ngjarjeve duhet, për këtë, të riprodhojë pamoren nëpërmjet vizatimit, dhe të zëshmen nëpërmjet pasqyrit të grafemor të tingujve; këto të fundit, që mesa duket janë të një niveli semiotik të ndryshëm përkundrejt pamores (të dukshmes), duhen ndarë në tinguj natyrorë (jo njerëzorë) dhe tinguj gjuhësorë (njerëzorë), dhe qysh në veprat amerikane të viteve ’30, çështja duket se është përcaktuar njëherë e mirë duke përvijuar hapësira përkatëse për secilën makrotipologji, të tingullit apo të zërit: brenda resë, në didaskali, apo brenda vetë vizatimit (shih fig. 4).

⁴ Duke përjashtuar për arsye të ndryshme hipotezat si “shkrues” (“*scrittorio*”), “shkrimëtuese”, “shkruese” (“*scritturale*”), i shkrueshëm (“*scritturale*”) dhe ndonjë formë tjetër që mund të mos pengohet nga prapashtesat fjalëformuese në italisht, termi “shkrimore”/“*scrittivo*” propozohet me qëllimin për t’iu referuar në mënyrë specifike teksteve të karakterizuara nga fenomene shkrimi, që përfshihen mes një shkalle kryesisht minimale (e folur-e shkruar) dhe një maksimale (“teksti të ndërshtënë”/ “perteksti”). Zgjidhja e termit “shkrimore” e ndreq gjithashtu dhe paradigmen vizive”.

⁵ Paraqitja e shqisave të nuhatjes, prekjës dhe shijes mund të përmblihen te dy të tjerat nëpërmjet vizatimit ose shkrimit.



Fig. 4. *The human Torch*, “Marvel Comics”, vol. 1 1939, n. 1.

Pamorja, pra, riprodhohet *iuxta propria principia*, - në përputhje me parimin e vet, d.m.th. në mënyrë të figurshme, falë pamjes së kornizuar dhe shfaqjes së anës pamore, ndërsa sonorja riprodhohet duke përdorur të figurshmen, treguesit pamorë nëpërmjet “thjesht” shkrimit të zërit, përveçse gjithë mjeteve të mundshme fonosimbolike që e bëjnë të mundur paraqitjen e tyre.⁶

Kjo gjë motivon dominimin gjerësisht të argumentuar të pamores mbi të zëshmen, të përmendur këtu, pasi e zëshmjia ia detyron pikërisht pamores mundësinë e ekzistencës te novela grafike. Në të kundërt, të dyja tekstet, ai në didaskali dhe ai brenda resë, janë në të njëjtën kohë shprehje e së folurës, por edhe e së shkruarës: e së folurës, sepse teksti brenda resë e imiton dhe e sugjeron, ndërsa teksti brenda didaskalisë është shkëputur prej tij: e së shkruarës, pasi të dyja janë fryt i zhvendosjes së mendimit, me qëllimin për t’u shprehur si në rrugë pamore ashtu dhe gojore, në një sistem shenjash në analogji me të parin (d.m.th. figurativ-pamor), por jo me të dytin (d.m.th. të zëshëm - përmes zërit/ “sonico”).

⁶ Për një paraqitje të “metaforave pamore” dhe dukurive të tjera të lidhura me disiplinën e “rrëfimit të animuar”/ “*fumetto*”-s, shih Catricalà 2012.

2.1. *Funksioni “tekstor”/ “tekstual” i objektit “të ndërshtënë”/ “pertekstual”*

Pasi u sqarua që teksti i “rrëfimit të animuar” mund të ketë hapësira paraqitjeje të mëtejshme përveç didaskalive, teksteve brenda “tymit”, kornizimeve të ndryshme pamore, për shembull, brenda trupit të ilustrimeve (vinjetave) veç hapësirave jashtë vinjetës, mund të thuhet se mjete të tilla mund të përdoren në mënyrë tekstualisht funksionale, përveçse pak a shumë të ndërgjegjshme (shih figurat 5 e 6) në këto lloj publikimesh.



Fig. 5. “Modellina”, viti VIII, N.5 1-8/02/1941, f.1.



Fig. 6. “Wonder Woman”, Archives v.I, n. 03, (newspaper).

Në fakt, nëse vizatuesi e ka të nevojshme të paraqesë një gazetë, ai mund të vizatojë një fletë të bardhë dhe të bëjë të dallueshëm me sy vetëm titullin, apo të paraqesë titullin dhe tekstin me shenja jo qartësisht të dallueshme/lexueshme. Por ai mund të provojë edhe ta bëjë titullin dhe tekstin të lexueshëm, gjë që nuk mund të mos nxisë arsyetime në një rrafsh të mundshëm analize “specifikisht gjuhësore”/ “kotekstore”⁷. Në të dyja rastet, çështja për t’u theksuar është ajo e shfrytëzimit të tekstit për subjektet me probleme në të lexuar. Në fakt, as në literaturën kushtuar disleksisë, që prek në mënyrë specifike ose përmend temën e rrëfimit të animuar, nuk është specifikuar “teksti i ndërshtënë”, në veçantinë e tij. Këto mangësi, e theksojmë sërish, rrafshojnë karakterin specifik komunikues të tekstit, që paradoksalisht nënkuptohet si tipari më i theksuar metagjuhësor që i atribuohet atij dhe që shpesh shpallet si element themelor kur tentohet të përcaktohen kufijtë e nocionit (Bronckart 2004, p. 115).

Kështu, në realizimin e “tekstit të ndërshtënë”, dizenjatori mund të shkojë deri aty sa të shtojë elemente të botës së jashtme në historinë e rrëfyer (deri dhe tregues kohorë), duke sugjeruar edhe përputhshmërinë me fakte që realisht kanë ngjarë, si p.sh., në rastin e paraqitjes së një kalendari, të emrit të një tipografie tek e cila ajo është botuar realisht.

⁷ “Koteksti”/ “cotesto” (*it.*) përmbledh elementet mirëfilli gjuhësorë të tekstit në aktin e komunikimit (fonemat, fjalët, sintagmat, frazat), dhe i kundërvihet termit “kontekst/contesto”.

Në procesin e krijimit të një “teksti të ndërshtënë”, dizenjatori i shton përpjekjet e tij, pasi i duhet të vendosë se çfarë të paraqesë si të lexueshme. Nuk është e rastësishme që flitet për “dizenjator”, pasi nuk është e thënë që “teksti i ndërshtënë” të hyjë tek elementet tekstore të përcaktuara qartësisht si të tilla nga skenaristi.

Një rast tjetër është ai i paraqitjes së një posteri që lajmëron një ngjarje, vërtetësia e së cilës në botën jashtë rrëfimit të animuar përputhet me atë të vetë rrëfimit të animuar, protagonistët e së cilës janë me të vërtetë ata që paraqiten në shembullin e paraqitur në rrëfimin e animuar/ “fumetto” (vlejnë për këtë shembujt e Vittorio Giardino-s (Giardino 2003, p. 35), si p.sh., ai i sjellë në figurën 7, ku emrat e posterit përkojnë me ato të autorëve të veprës, po kështu dhe koha kalendarike (për një analizë gjuhësore të veprës së V. Giardino-s të shihet Aprile/Zeoli 2005). Kjo është e kundërta e paraqitjes së një posteri të fushës së Disney (Disney 1993, p. 5) ku realizimi i ngjarjes në botën jashtë “rrëfimit të animuar” nuk përkon me paraqitjen e saj brenda rrëfimit të animuar dhe ku protagonistët nuk u përkasin aktorëve të ndonjë shfaqjeje, por personazheve të vetë rrëfimit të animuar (fig. 8); gjë që ka një farë arsyeje që të ekzistojë, por që zbehet nga kujdesi i paktë që tregohet për argumentimin së brendshmi të shkrimit të *shtypur* (e theksojmë këtë aspekt): dritë-hijet e shkronjave, faqosja e të tjera.



Fig. 7. Vittorio Giardino – “Max Fridman”, n. 20, f.45, Poster teatri.



Fig. 8. Topolino, “Miseria e Nobiltà”, n.1955, 16.05.1993, f. 5-1.

Kuptohet, pra, që çështja nuk është aq e thjeshtë për t’u inkuadruar, pasi do të duhej të regjistroheshin dhe klasifikoheshin të gjitha tekstet e ndërshtëna në rrëfimin e animuar (për t’u kufizuar vetëm në një kontekst të mundshëm analize); dhe, siç mund të kuptohet, nëse përpjekja për të realizuar një regjistrim mund të ketë një mundësi realizimi të paktën në rrafsh shembujsh, realizimi i klasifikimit në tipe të teksteve të paraqitura në tekste të tjera, do të ishte më i vështirë, pasi baza teorike e metodologjike mungon ende.

Ndër kriteret që do të mund të mbështetnin një nismë të tillë, dhe që mendohet të jenë të shumtë, ai i natyrës informuese të tekstit/ “informativitetit tekstor”, duket veçanërisht i nevojshëm. Me termin “informativitet” e kam

fjalën për kriterin specifik homonim të gjuhësisë së tekstit, që Beaugrande dhe Dressler-i e përcaktuan si “njësia matëse, nëse një paraqitje tekstore është e re ose e papritur për marrësin” (Beaugrande-Dressler 1984, p. 157), dhe që ngelet ndoshta përcaktimi më i mirë i dukurisë. Për këtë, përtej inkuadrimin të këtij të fundit dhe statistikave mbi të, kriteri i informativitetit mund të jetë një kriter i nevojshëm për të realizuar një reflektim të parë mbi “tekstin e ndërshtënë”, pasi ai mund të jetë pak a shumë informativ, gjë që varet edhe nga vetëdija me të cilën realizohet. “Tekstet e ndërshtëna”, gjithashtu, për nga natyra janë të shkurtra, meqë “rrëfimi i animuar” është korniza e tyre ideale, prandaj dhe karakteri informues duhet të kryhet brenda kësaj shfaqjeje të tyre të natyrshme. Në analizën tekstore të “rrëfimit të animuar”, pra, nyja lidhëse mes karakterit informues dhe shkurtësisë, duhet konsideruar themelore dhe shpesh janë pikërisht tekstet e ndërshtëna që plotësojnë nevojën e dhënies së informacionit.

Me vënien në pah të ekzistencës së “tekstit të ndërshtënë” si objekt studimi, do të ishte e nevojshme të punohej për një klasifikim të sistemuar të tij, duke filluar nga shkalla zero e lexueshmërisë, si i lexueshëm/ i palexueshëm, për të përfshirë këndvështrimin sociolinguistik dhe për të mbërritur në atë tekstor (falë mundësive që jep përzgjedhja e llojit të objektit “pertekstual” apo vetë tekstor: titulli, artikulli, tabela publicitare, sinjalistika, etj., apo natyrisht të kontekstit të përdorimit: “rrëfim i animuar”, publicitet, kinema, etj.) dhe për të vazhduar në atë pragmatik funksional, por dhe kontekstual: përgjithësisht një shkrim, përveç informacionit që i jep lexuesit, duke nxitur një përfshirje, mund të shkaktojë një lloj sjelljeje te personazhi.

Nga ana tjetër, përsa i përket funksionit, duhet mbajtur parasysh, për shembull, në cilën pikë të historisë së rrëfyer gjendet teksti i ndërshtënë: në fillim të ngjarjes, në fakt, një shkrim mund të shërbejë të krijojë një mjedis apo të karakterizojë një personazh; ndërsa brenda ngjarjes, ai mund të shërbejë për t’i dhënë zhvillim historisë, apo të lëvizë personazhin nga një drejtim në tjetrin.

Shumësia e arsytimeve të mundshme sociolinguistike, pragmatike, tekstore të ofruara nga “tekstet e ndërshtëna”, mund të sendërtohet në një rrjet faktorësh dhe tiparësh që, sidomos kur bashkekzistojnë, i japin shkas formimit të sythave tipologjikë për një sasi të pafund formash shkrimi, të cilat do të ndriçonin procesin e komunikimit që ato nxisin brenda tekstit, dhe jo vetëm brenda tij. Perspektiva të tjera ngelen sigurisht për t’u parë dhe evidentuar, dhe njëra është, pa dyshim, ajo e përkthimit të “tekstit të ndërshtënë”: edhe nga ky këndvështrim mungon plotësisht, në fakt, kujdesi për këtë lloj teksti dhe në përgjithësi për tekstet e përkohshme.

Përfundime

Të ndërgjegjshëm për faktin se mund t'i mbishtresohemi arsytetimeve të kryera në të shkuarën, dhe për faktin se sapo e kemi cikur këtë çështje që ende duhet përpunuar në mënyrën e duhur, në këtë paraqitje hyrëse u përpoqëm të emërtojmë tekstin e përkohshëm dhe të qëmtojmë disa shfaqje të ndryshme tekstore të ndërmjetësuar nga vetë tekstorësia.

Në lidhje me këto të fundit, u ndalëm tek ndërshtënia tekstore”, duke u munduar të vëmë në dukje ekzistencën e “tekstit të ndërshtënë” si entitet shkrimor i pavarur të “rrëfimi i animuar” apo kornizat tekstore në formën e pamjeve, figurave dhe teksteve të ndërshtëna në to, dhe të sugjerojmë rëndësinë e tyre në rrafsh tekstor. Elementet e “ndërshtënies tekstore” të “rrëfimi i animuar” janë përsosur me kalimin e viteve dhe ndonjëherë është didaskalia që merr rol qendror dhe herë tjetër reja (korniza ku ndërfutet teksti), siç mund të vëzhgohet në figurën 9, ku paraqitet një vinjetë e cila, në tërësinë e saj, është një “tekst i ndërshtënë”: faqe e një numri të gazetës “Daily Portent”, që nuk ka ekzistuar në realitet. Sigurisht nuk bëhet fjalë për përmirësime që u takojnë të gjithë botës së “rrëfimit të animuar”, por për korrigjime që i bëhen paraqitjes së “tekstit të ndërshtënë”, tashmë në mënyrë pak a shumë eksperte, duke e bërë më të ndërgjegjshme fazën e krijimit të tij.




Fig. 9. Chris Ware, “Jimmy Corrigan, the smartest kids on earth”, vol. 6, n. 5, 1995, f. 24.

Raste të shkallëve të ndryshme të interesit që i është rezervuar këtij fenomeni, shihen te rrëfimi i animuar ku paraqiten faqe gazetash që ekzistojnë në botën reale, me tekst të lexueshëm, por me rrëfime ngjarjesh të cilat aty (në gazetën reale) nuk kanë qenë, apo letra të cilat u referohen fakteve të ndodhura në ngjarjen e rrëfyer dhe që janë të lexueshme (me stil ndërtekstor fortësisht gazetaresk, apo nëse mund të specifikohet, me stil që i ngjan një lloji stili të caktuar gazetaresk); apo, faqe librash që kanë ekzistuar në botën reale, me citime të lexueshme, por që nuk gjenden realisht në librin e vërtetë etj. E gjitha kjo ndodh zakonisht pa lënë mënjanë cilësinë e brendshme të shkurtësisë (shih

Chiusaroli/Zanzotto 2012) të kontekstit specifik tekstor, bazuar në nevojën për të thënë sa më shumë në sa më pak tekst që është e mundur, gjë që më shumë se konsideratat e tjera, përputhet me nevojën për ta vënë këtë kontribut në shërbim të reflektimit më të përgjithshëm për tekstorësinë.

BIBLIOGRAFI E PËRGJITHSHME

- Aprile, M., Zeoli, S., *Le porte d'Oriente*. Lettura linguistica dei fumetti di Vittorio Giardino, San Cesario di Lecce, Manni, 2005.
- Bazzanella, C., 'Ripetizione polifonica' nei titoli dei giornali, in P. D'Achille (a cura di), *Generi, architetture e forme testuali*, Atti del VII Convegno SILFI (1-5 ottobre 2002), Vol. I, Firenze, Cesati, 2004, pp. 241- 256.
- Beaugrande R. A. de, Dressler, W. U., *Introduzione alla linguistica testuale*, Bologna, Il Mulino, 1984.
- Bouquet, J., *Tatouages décoratifs tunisiens*, "Revue d'histoire de la pharmacie", 24^e année, n° 93 (1936), pp. 277-283.
- Bronckart, J.-P., *Les genres de textes et leur contribution au développement psychologique*, "Langages", 153 (2004), pp. 98-108.
- Brown et al., *Encyclopedia of Language and Linguistics*, 2nd Edition, Oxford, Elsevier, 2005.
- Bussmann, H., *Dictionary of Language and Linguistics*, translated and edited by Gregory Trauth and Kerstin Kazzazi, London and New York, Routledge, 2006 [1990].
- Cacchioli, L., Tiburzi, A., *Lingua e forme dell'epigrafia in volgare (secc. IX-XV). 1. Scrivere il volgare: su pietra, sui muri. 2. Esporre perché: tipologie e funzioni*, "Studj romanzi", n.s. X (2014), pp. 311-352.
- Cardona, G.R., *Antropologia della scrittura*, Torino, UTET, 2009.
- Catricalà, M., *Voci, ideofoni e balloon: gli spazi fonico-uditivi del fumetto*, in A. Manco (a cura di), "Comunicazione e Ambiente, L'Orientale", Napoli, 2012, pp. 191-200.
- Chiusaroli, F., Zanzotto, F.M., *Scritture brevi di oggi*, "Quaderni di Linguistica zero", Napoli, 2012.
- Ciociola C. (a cura di), «Visibile parlare». *Le scritture esposte nei volgari italiani dal Medioevo al Rinascimento*, Atti del Convegno Internazionale di Studi Cassino- Montecassino, 26-28 ottobre 1992, Napoli, Edizioni Scientifiche Italiane, 1997.
- Crystal, D., *A Dictionary of Linguistics and Phonetics*, 6th Edition Oxford, Blackwell Publishing, 2008.
- D'Achille, P., *L'italiano contemporaneo*, Bologna, Il Mulino, 2010.
- Geymonat, F., *Scritture esposte*, in "Storia dell'italiano scritto". III. Italiano dell'uso, a cura di G. Antonelli, M. Motolese, L. Tomasin, Carocci,

- Roma, 2014, pp. 57-93.
- Ginocchietti, M., *La nozione di performatività: un confronto tra Judith Butler e John L. Austin*, “Esercizi Filosofici”, 7 (2012), pp. 65-77.
- Groensteen, T., *The System of Comics*, trad. di Bart Beaty e Nick Nguyen, Jackson, University Press of Mississippi, 2007 (trad. di Système de la bande dessinée, 1999).
- Guerra, N., *Il labile discrimine tra spazio urbano e spazio linguistico. La città come dimensione spaziale costitutiva della variazione, del contatto e dell'innovazione linguistica. Il ruolo del graffitismo, del muralismo e dello stickerismo*, GRIN Verlag, Monaco di Baviera, 2012.
- Mancini, A. *L'annotazione del fumetto: un 'linguaggio breve' per le 'scritture brevi'*, in F.M. Dovetto, S. Leonardi, A. Manco, E. Morlicchio (a cura di), “Scritture brevi e variabilità diatecnica”, Atti del Convegno svoltosi all'Università di Napoli L'Orientale, 26-28 giugno 2014.
- Orioli, F., *Iscrizioni di autori diversi. Con un discorso sulla epigrafia italiana*, Sassi, Bologna, 1827.
- Petrucci, A., *La scrittura fra ideologia e rappresentazione*, in “Storia dell'arte italiana”, vol. III, t. 2/1, Torino, 1980, pp. 3-123.
- Sabatini, F., *Voci nella pietra dall'Italia mediana. Analisi di un campione e proposte per una tipologia delle iscrizioni in volgare*, in Id., *Italia linguistica delle origini*, Lecce, Argo, 2 voll., vol. II, pp. 569-625.
- Ronzon, L., *Il museo si prende cura delle parole*, in M. T. Zanola (a cura di), “Terminologie specialistiche e tipologie testuali. Prospettive interlinguistiche”, Università Cattolica, Milano, 1997, pp. 95-102.
- Scialoja, T., *Poesie 1979-1998*, Milano, Garzanti, 2009.
- Walker, M., *The Lexicon of Comicana*, Port Chester, NY, Comicana, Inc, 1980.

Përktheu: **Blerina SUTA**

SUMMARY

TEXTS MEDIATED FROM TEXTS: INSTABILITY AND PERTEXTUALITY

“TEXT/TEXTUALITY: This is not a definition”

The text-mediated textuality field is still not so clearly defined and this may in part explain the lack of labels to accurately isolate the related phenomena. In seeking an initial identification and classification of similar textual representations, the first part of this work will attempt to define as “precarious” any written texts on more or less permanent support surfaces such

as parts of the human body (e.g. skin, nails, etc.), clothing, walls or any other surfaces (doors, furniture, etc.) of public bathrooms, school desks, outdoor walls, benches, trees, and so on. The aim is an attempt at suggesting the need to reverse the broadly generic consideration trend of precariousness in which these texts are now being held to their being metalinguistically defined and to appreciate with scientific objectivity writings that are otherwise considered as being too low in textual content value. The second part of this work tries to isolate three types of phenomena while offering the definition of “crosstextuality”, “pertextuality” and “surtextuality”. I especially dwell on the second type of text while I identify and try to describe Comics as a place of choice for this type of expression.

